



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri

NJË QASJE GJITHËPËRFSHIRËSE PËR QEVERISJEN E SEKTORIT TË SIGURISË DHE “BORXHI I TEZEUT”

*Op-ed nga ambasadori Vincenzo Del Monaco
Kryetar i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri*

Qeverisja e sektorit të sigurisë është, pa dyshim, e rrënjosur në Organizatën ku kam nderin të shërbej në Shqipëri: OSBE. Tema mund të duket teorike në pamje të parë, deri edhe e pakuptueshme. Mund të tingëllojë si një temë debati te qarqet e brendshme, midis ekspertëve. Shumë keq! E kundërta është e vërtetë: qeverisja e sektorit të sigurisë mund të jetë efektive vetëm nëse shoqëria civile është pjesë aktive e ligjërimit. OSBE-ja e di këtë tepër mirë, përmes kuptimit unik të thelluar të sigurisë dhe aftësisë së saj për të siguruar një platformë për dialog në terren. Unë pata mundësinë për të debatuar rreth mënyrës së përfshirjes së shoqërisë civile në qeverisjen e sektorit të sigurisë vetëm para disa ditësh, në një veprimtari të madhe të bashkëdrejtuar nga Kryesia Suedeze dhe Qendra për Parandalimin e Konfliktëve, në bashkëpunim me Akademinë Folke Bernadotte. Ndava me familjen e OSBE-së vlerësimin tim pozitiv të aktiviteteve tona si Prezencë e OSBE-së. Konferenca, gjithashtu, më ofroi mundësinë për të reflektuar mbi takimet e mia të fundit në një sërë qytetesh shqiptare, me kryetarë bashkish, prefektë dhe drejtorë policie.

Unë besoj se, në botën e sotme, liria dhe pluralizmi nuk mund të sigurohen vetëm përmes ndarjes klasike të pushteteve të identifikuar nga Monteskjë tre shekuj më parë. Ekziston një lloj ndarjeje e re e punës në nivele të ndryshme të pushtetit: kryesisht një nivel kombëtar, por edhe mbikombëtar dhe ndërkombëtar. Dhe do të shtoja edhe një nivel nënkombëtar, me një rol në rritje që luhet nga aktorë joshtetërorë. Ne kaluam nga një botë e fuqisë së përqendruar në një fuqi shumë më të shpërndarë. Kjo është arsyeja pse OSBE-ja dhe Prezenca kanë përqaftuar qasjen e tërë shoqërisë në adresimin e çështjeve që lidhen me sigurinë.

Më konkretisht, një ilustrim i mirë i rolit pozitiv që shoqëria civile luan në sigurinë në Shqipëri është krijimi i një grupi këshillimor që adreson çështjet mjedisore. Grupi është i përbërë nga 18 anëtarë nga shoqëria civile dhe media, dhe ka aftësinë për të siguruar ekspertizë dhe udhëzime për agjencitë e zbatimit të ligjit në lidhje me shkeljet mjedisore. Kontributi i tij, midis të tjerave, çoi në ndryshimin e dispozitave të kodit penal për shkeljet mjedisore, për ta pasuruar atë me dispozita të reja mbi krimin e mbetjeve, krimet kundër mjedisit natyror dhe atë mbi tregtimin e faunës së egër. Ne nuk punojmë vetëm me organet qendrore dhe, për këtë arsye, unë kam udhëtuar gjerësisht në të gjithë vendin, gjatë dy muajve të fundit, për të angazhuar institucione dhe aktorë vendorë, për të eksploruar shtigje të reja për bashkëpunimin tonë, për të dëgjuar prej tyre se si ata u japin përparësi dhe adresojnë çështjet e sigurisë. Kam theksuar rëndësinë e Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike, 54 gjithsej, por me vendosmëri në qëllimin tonë që ato të ngrihen në të 61 bashkitë e vendit. Ato shihen si një përpjekje për të bashkuar

aktorët kryesorë për sigurinë publike në nivelin vendor, në mënyrë që të bashkohen me politikën, planifikimin dhe burimet për të bashkëpunuar në mënyrë efektive dhe adresuar çështjet e sigurisë në komunitet.

Partneriteti është, në të vërtetë, një vatrë shumë e vlefshme për të ndërtuar besimin në institucione, për të nxitur një kulturë transparence dhe llogaridhënie midis aktorëve të angazhuar. Ne, rregullisht, i kemi përfshirë të rinjtë në problemin e sigurisë. Angazhimi i tyre, bërja e tyre qytetarë të fuqizuar është një recetë e mirë për të zvogëluar rrezikun e dhunës dhe kimit. Prandaj, në vitin 2020, Prezenca zhvilloi një paketë gjithëpërfshirëse të trajnimit mbi sigurinë e të rinjve, që përfshin konceptin modern të sigurisë, zgjidhjen e konflikteve, rolin e të rinjve në parandalimin e dhunës, ekstremizmit të dhunshëm dhe dhunës në familje, mbi angazhimin e të rinjve në vendimmarrje dhe partneriteti i të rinjve me aktorë të sigurisë. Një nga pjesëmarrësit në seminarin në Berat, Rahela, tha: “Ky seminar më ndërgjegjësoi për kërcënimet e sigurisë. Tani do të jem më e vetëdijshme dhe do të di si të mbrohem nga këto kërcënime dhe ku t’i adresoj shqetësimet e mia në lidhje me sigurinë time”. Prandaj jemi këtu!

Është e qartë se ekziston gjithashtu një lidhje me Gratë, Paqen dhe Sigurinë (GSP). Që nga koha e grekëve të lashtë, gratë ishin pjesë aktive në debatet mbi sigurinë. Të gjithë e kujtojmë kërcënimin e sigurisë të paraqitur nga Minos, dhe numrin e viktimave që provokoi lufta kundër tij. Ishte një grua, Ariana, ajo që i dha Tezeut, fillin për të hyrë në labirint, të triumfojë mbi Minosin dhe të kthehet në jetë. “Borxhi i Tezeut” ndaj grave është, nga ana intelektuale, në themel të asaj që ne e quajmë sot Gratë Paqja dhe Siguria. Në vazhdim, si Prezencë e OSBE-së në Shqipëri, ne i kushtojmë vëmendje të madhe integritetit gjinor dhe veçanërisht programit për gratë, paqen dhe sigurinë. Në këtë kontekst, së bashku me organizatat partnere, të tilla si UN Women dhe ambasada holandeze, ne kontribuam në bashkërendimin e përpjekjeve që sollën miratimin e Planit të parë të Veprimit të Grave, Paqes dhe Sigurisë në Shqipëri të zbatuar në vitet 2019-2020 si dhe përgatitjen e planit të ardhshëm të veprimit. Angazhimi i Prezencës për të mbështetur Planin Kombëtar të Veprimit të Shqipërisë për Rezolutën 1325 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara ka treguar se aktivistët dhe shoqatat e shoqërisë civile janë thelbësore për promovimin dhe përparimin e planeve kombëtare të veprimit për GSP-në, veçanërisht kur bëhet fjalë për zbatimin e tyre praktik - duke filluar nga masat në lidhje me qasjen në drejtësi, identifikimin, mbrojtjen e viktimave dhe rehabilitimin, deri te masat që adresojnë veprime pozitive për të promovuar gratë në pozitat udhëheqëse në misionet e paqes jashtë vendit, zbatimin e ligjit në shtëpi dhe politikëbërjen për Paqen dhe Sigurinë e Grave, si në shtëpi ashtu edhe në nivel ndërkombëtar. Përfshirja e shoqërisë civile bëhet gjithnjë e më e rëndësishme kur bëhet fjalë për monitorimin dhe mbajtjen e përgjegjësisë nga aktorët shtetërorë për të, siç ka treguar përvoja e Rrjetit Shqiptar për Gratë, Paqen dhe Sigurinë.

Unë arrij në përfundimin se çdo rend apo sistem, për të qenë vërtetë efektiv, duhet të vlerësohet nga ajo që arrin të japë konkretisht, dhe masa përfundimtare e çdo përpjekje për reformë është nëse prodhon apo jo përfitime për qytetarët. Kur shumica e popullsisë i gëzon këto përfitime, kur gjykon se ka një rol në debatin kombëtar, atëherë ne mund të jemi të sigurt se klima është e favorshme për mirëqenie, stabilitet dhe siguri. Ky është rrugëtimi drejt një shoqërie vërtetë të hapur.